

VENDIM
Nr. 117, datë 28.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 421, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË
PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË
SHKODRËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 8, shkronja “a”, dhe 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të

shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën përfundimtare të pronave, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i destinacionit të një sipërfaqeje prej 428 m² të katit përdhes të godinës, me numër rendor 61 dhe me numër pasurie 4/49, sipas planimetrisë bashkëlidhur, nga fusha e përdorimit “Pronë për realizimin e programeve arsimore”, për t’u përdorur për ngritjen e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara të ADISA-s, në Bashkinë Shkodër.


2. Bashkisë Shkodër i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Shkodër dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

SIP. = 428.0 m2



PLANI I VENDOSJES SHK. 1:500

MIRATOHET
KRYETAR I BASHKISË
VOLTANA ADEMI



ZONA KADASTRALE 8594

NR. PAS. 4/49

RRUGA: EDIT DURHAM

SIP. = 428.0 m2

PUNOI: ADNAN BUSHATI

Adnan Bushati